



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

“PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE AFATEVE PËR
ZBATIMIN E GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË MBETJEVE PËR
TË GJITHA RRYMAT E MBETJEVE”¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 57/2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e ministrit të mjedisit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Objekti i këtij vendimi është miratimi i kriterëve, procedurave dhe afateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, me qëllim lehtësimin ose përmirësimin për përgatitjen për ripërdorim, riciklim dhe operacioneve të tjera të rikuperimit për rrymat e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.
- Në kuptim të këtij vendimi, rryma e mbetjeve që i nënshtrohen grumbullimit të diferencuar janë rrymat e mbetjeve bashkiake, sipas përkufizimit në pikën 21, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2025 ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, në zbatim të skemave të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Për rrymat specifike të mbetjeve, që nuk përfshihen në pikën 2 të këtij vendimi, zbatohen parashikimet e Kreut IV, të ligjit nr. 57/2025.

¹ Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

4. Përjashtohen nga detyrimi për grumbullim të diferencuar rastet kur plotësohet një nga kushtet e parashikuara në pikën 2, të nenit 12 të ligjit nr. 57/2025.

II. KRITERET PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE

1. Grumbullimi i diferencuar i rrymave të mbetjeve të parashikuara në kreun IV, të ligjit nr. 57/2025, kryhet nga zotëruesit e mbetjeve, në mënyrë të tillë që të garantohet:
 - a) parandalimi i përzierjes së rrymave të mbetjeve, me qëllim ripërdorimin, riciklimin dhe operacionet e tjera të rikuperimit.
 - b) parandalimi i ndotjes së mjedisit dhe çdo ndikimi negativ në shëndetin e njeriut.
2. Grumbullimi i diferencuar kryhet duke përdorur kontejnerë ose pajisje të posaçme, që plotësojnë këto kritere:
 - a) të jenë të përshtatshme, të mbyllura ose të pajisura me masa mbrojtëse kur kërkohet, për të parandaluar rrjedhjet dhe shpërndarjen e mbetjeve në mjedis;
 - b) të jenë rezistente ndaj dëmtimeve mekanike dhe kushteve atmosferike;
 - c) të jenë të lehtë për t'u pastruar dhe kur kërkohet, për t'u dezinfektuar;
 - ç) të jenë të identifikueshëm përmes ngjyrave specifike për çdo rrymë mbetjesh, sipas kërkesave të Bashkimit Evropian.
 - d) Të jenë të pajisura në pjesën e jashtme me etiketa të dukshme, të lexueshme dhe rezistente, që tregojnë qartë llojin e mbetjeve të lejuara për depozitimin.

III. PROCEDURAT PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR TË MBETJEVE

1. Krijuesit e mbetjeve ndajnë mbetjet në burim, në përputhje me mënyrën e përcaktuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Zotëruesit e mbetjeve grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet sipas rrymave specifike duke i depozituar në pikat e shërbimit ose në pikat e grumbullimit të përcaktuara nga njësitë e qeverisjes vendore, ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme që nuk bie ndesh me legjislacionin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
3. Grumbullimi i diferencuar kryhet në përputhje me grafikun, frekuencën, oraret dhe mënyrën e grumbullimit të vendosur nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke marrë në konsideratë rrymën mbetjeve, densitetin e popullsisë dhe kushtet teknike e infrastrukture të zonës.

1 Ky vendim është përafëruar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

4. Zotëruesit e mbetjeve që ushtrojnë aktivitetet në fushën e grumbullimit të mbetjeve janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e pikës 3 të këtij kreu.
5. Operatorët, që nuk janë të pajisur me leje mjedisi të tipit B, apo me licencë III.2.b, raportojnë pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, të dhënat për sasinë dhe llojin e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar.
6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, raportojnë brenda datës 28 shkurt të çdo viti pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mbi:
 - a) sasinë dhe llojin e mbetjeve të grumbulluara në mënyrë të diferencuar;
 - b) frekuencën e grumbullimit;
 - c) mënyrën e grumbullimit;
 - ç) identifikimi i kontraktorëve të përfshirë në shërbimin e grumbullimit;
 - d) destinacioni i mbetjeve;
 - dh) sasia e mbetjeve të trajtuara/përpunuara dhe lidhjen me sasinë e grumbulluar;
 - e) problematikat e konstatuara;
 - ë) masat e marra për përmirësimin e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve.
7. Agjencia Kombëtare e Mjedisit analizon dhe përpunon të dhënat e raportuara sipas pikës 6 të këtij Kreu dhe përgatit raportin vjetor të mbetjeve brenda datës 31 maj të çdo viti.

IV. AFATET PËR GRUMBULLIMIN E DIFERENCUAR

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masat e nevojshme për arritjen e objektivave kombëtare brenda këtyre afateve:
 - a) deri më 31.12. 2030, minimumi 65% i peshës së të gjitha mbetjeve të ambalazheve të riciklohet.
 - b) deri më 31.12. 2030, të arrihen të paktën këto nivele minimale të riciklimit sipas rrymave të mbetjeve
 - i. 50% plastikë;
 - ii. 25% dru;
 - iii. 70% metale me ngjyra;
 - iv. 50% alumin;
 - v. 70% qelq;
 - vi. 75% letër/karton;

1 Ky vendim është përafshuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, "Mbi mbetjet", e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.

c) deri më 31.12. 2035, minimumi 70% i peshës së mbetjeve të ambalazheve të riciklohet;

ç) deri më 31.12. 2035, të arrihen këto nivele minimale riciklimi sipas rrymave:

- i. 55% plastikë;
- ii. 30% dru;
- iii. 80% metale me ngjyra;
- iv. 60% alumin;
- v. 75% qelq;
- vi. 85% letër/ karton

d) të arrihet minimumi i përgatitjes për ripërdorim dhe riciklim i mbetjeve bashkiake:

- i. 25% deri në vitin 2030;
- ii. 50% deri në vitin 2033;
- iii. 55% deri në vitin 2035,
- iv. 60% deri në vitin 2040 dhe
- v. 65% deri në vitin 2045.

V. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 418, datë 25.6.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, shfuqizohet.
2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA

1 Ky vendim është përafuar plotësisht me direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Mbi mbetjet”, e ndryshuar, e cila shfuqizon disa direktiva. Numri CELEX: 32008L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 312, datë 22. 11. 2008, faqe 3–30.